



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Ref: 1305/709/BA/dk

VENDIMI I BORDIT PËR ANKESA T

në çështjen e Ankesës nga

Radio Television 21

(“Pala ankuese”)

I përfaqësuar nga:

Znj. Afërdita Kelmendi-Drejtoreshë e RTV 21

z. Eugen Saraçini- RTV 21

znj. Ardita Zejnullahu-AMPEK

kundër vendimit të
Komisionit të Pavarur për Media (“KPM”)

në ankesën 2012/88
(Vendimi i KPM-së i 28 dhjetor 2012)

Historiku dhe faktet

1. Me vendimin e tij të datës 28 dhjetor 2012 (Ref.: 1301/010/KPM/az), Komisioni ka shqiptuar gjobën prej 15.000 € kundër palës ankuese, TV 21, për shkelje të nenit 15, paragrafi 3, të Rregullores KKPM-2009/04.
2. Më 11 shkurt 2013, brenda afatit ligjor, pala ankuese ka parashtruar ankesë kundër vendimit sanksionues të Komisionit. Në këtë ankesë, TV 21 pretendon se Vendimi i Komisionit nuk ka qenë vendim i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe prova.
3. TV 21 më marrjen e Licencës, ka nënshkruar Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe është obliguar që të respektojë të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, përfshi edhe Rregulloren për Komunikimet Komerciale audio-vizuale.
4. KPM-ja ka bërë monitorime të vazhdueshme të Palës Ankuese për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale KKPM 2009/04. Me rastin e monitorimit të programit të transmetuar nga Pala Ankuese me datën

3 korrik 2012, KPM-ja ka gjetur se gjatë kësaj periudhe Pala Ankuese është në shkelje të nenit 15.3 të Rregullores KKPM 2009/04.

5. KPM-ja bazuar në shkeljen e Rregullores KKPM-2009/04, nga ana e Palës Ankuese me datën 10 korrik 2012, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin nga Pala Ankuese është kërkuar të veprojë në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren KKPM-2009/04, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Ankuese.
6. KPM-ja edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, sërish me datën 29 gusht dhe 4 shtator 2012, ka bërë monitorimin e Palës Ankuese për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KKPM-2009/04. KPM-ja ka gjetur se Pala Ankuese edhe përkundër Njoftimit për Shkelje të datës 10 korrik 2012, ka përsëritur të njëjtat shkelje dhe nuk ka marrë asnjë veprim përmirësues dhe ka vepruar në kundërshtim të vazhdueshëm me Rregulloren KKPM-2009/04, pasi që ka tejkaluar minutazhin e lejuar brenda një ore për transmetimin e komunikimeve komerciale, që është përcaktuar me nenin 15.3 të Rregullores KKPM-2009/04.
7. KPM bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Rregullores KKPM-2009/04, nga ana e Palës Ankuese, me datën 6 shtator 2012 i ka dërguar Vërejtje me shkrim për shkelje të nenit 15.3 të Rregullores KKPM 2009/04. KPM me anë të Vërejtjes më shkrim edhe një herë ka kërkuar nga Pala Ankuese të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM 2009/04, në të kundërtën KPM në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së do të ndërmerr masa ligjore ndaj televizionit 21.
8. KPM bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Palës Ankuese, me datën 15 tetor 2012, ka bërë monitorimin e televizionit 21, ku ka gjetur se Vërejtjes me shkrim televizioni 21 ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren KKPM 2009/04.
9. KPM sërish me datën 5 dhjetor 2012, ka bërë monitorimin e televizionit 21 për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KKPM 2009/04. Gjatë monitorimit një javor që i është bërë TV 21, është konstatuar se ky subjekt vazhdon të jetë në shkelje të nenit 15, paragrafi 3, të Rregullores KKPM 2009/04.

Seanca dëgjimore


10. Në seancën dëgjimore të mbajtur më 7 maj 2013, përfaqësuesit e TV 21 përsëritën argumentet e tyre sikurse edhe përfaqësuesit e KPM-së. Përfaqësuesit e RTV 21 në veçanti theksuan se Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audio Vizuale KKPM 2009/04 është zbatuar në mënyrë selektive nga ana e KPM-së, si dhe kundërshtuan Vendimin e Komisionit duke e konsideruar vendim jo të drejtë dhe jo të bazuar në fakte dhe prova si dhe duke e kundërshtuar nivelin e gjobës. Gjithashtu RTV 21 theksoi se që nga momentin kur ka hyr në fuqi Ligji i RTK-së Rregullorja KKPM-2009/04, i rregullon vetëm TV komerciale, duke mos e rregulluar në këtë rast edhe transmetuesin publik.
11. Përfaqësuesit e KPM-se argumentuan se lartësia e gjobës ka ardh si rezultat i shkeljeve të vazhdueshme nga ana e TV 21. Përfaqësuesit e KPM-së gjithashtu argumentuan se në bazë të Rregullores KKPM-2009/04, transmetuesit komercial e kanë të ndaluar transmetimin e komunikimeve komercial me shumë se 12 minuta brenda një ore transmetim dhe se TV 21 nuk ka respektuar këtë obligim ligjor

Vendimi dhe arsyet

12. Bordi për Ankesa (BA) në seancën e datës 7 maj 2013, konstatoi se nuk kishte kontestim të fakteve, d.m.th. RTV 21 nuk ishte në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM 2009/4 për komunikimet komerciale audio-vizuale për shkak të transmetimit të reklamave në mënyrë të vazhdueshme mbi normën e lejuar.
13. Në Ankesën e TV 21, kundër vendimit të Komisionit të datës 28 dhjetor 2012, nr. 2012/88, Ref. 1301/010KPM/az, i shqyrtuar nga Bordi i Ankesave me datën 7 maj 2013, Bordi konstatoj që shkeljet e Rregullores KKPM-2009/04, të pohuara nga KPM ishin të bazuara. Sa i përket nivelit të gjobës, Bordi pas shqyrtimit të argumenteve nga TV 21 dhe KPM, ndryshoj vendimin sanksionues nga 15 mijë euro në 10 mijë euro, duke u bazuar në rrethanat lehtësuese të shqyrtuara nga ana e Bordit, si pranimin i shkeljes, vendimi i parë sanksionues, si dhe disa rrethana tjera lehtësuese. Bordi konstaton se kjo shumë e gjobës do të arrin efektin përmirësues të TV 21 që në të ardhmen të veprojnë në pajtim me Rregulloren KKPM-2009/04.

Rishikim procedural

14. Vendimet e bordit janë përfundimtare në pajtim me nenin 44.2 të Ligjit për KPM-në.
15. Palët ndaj vendimit të Bordit për Ankesa mund të paraqesin kërkesë për shqyrtim procedural në Gjykatë Supreme të Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi.
16. Inicimi i shqyrtimit procedural nuk ndalon zbatimin e vendimit të Bordit për Ankesa të KPM-së.


Daut Krasniqi
Kryetar, Bordi për Ankesa



04.06.2013

data